



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:022163

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06324046

C-IV-14-0091

Parashtruesi i kërkesës

F M nga fshati D, Komuna e Ferizajit, të cilin e përfaqëson avokat K A nga Ferizaji,

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – (AKP) (NSH “Plantacioni i Pemëve” në Likuidim), Rr. “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 21 tetor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHEN vendimet e Autoritetit të Likuidimit GJI012-0085 datë 13 nëntor 2013, GJI-012-0086 datë 13 nëntor 2015 dhe GJI012-0087 datë 13 nëntor 2013.**
- III. Secila palë i mbulon shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 6 janar 2014, pranë DHPGJS-së, ankuesi parashtror kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (AL), si në vijim:

- a. GJI012-0085 datë 13 nëntor 2013 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin është refuzuar kërkesa për tre (3) paga të papaguara, në shumë prej 450.00 (katër pesë zero) Euro,
- b. GJI012-0086 datë 13 nëntor 2013 (në tekstin në vijim Vendimi), me të cilin është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme së marrëdhënies së punës, në shumë prej 900.00 (nëntë zero zero) Euro, dhe
- c. GJI012-0087 datë 13 nëntor 2013 (në tekstin në vijim Vendimi), me të cilin është refuzuar kërkesa për kompensim të pagave të papaguara në shumë prej 25,200.00 (dy pesë dy zero zero) Euro, periudhën nga muaji shkurt 1991 e gjer në privatizimin e NSH,

që të gjitha këto kërkesa ndaj NSH “Plantacioni i Pemëve” (në likuidim).

Ankuesi pohon se NSH është privatizuar me 4 mars 2005 dhe se si rezultat i privatizimit të gjithë punëtorët e NSH kanë humbur vendin e tyre të punës.

Ankuesi në vijim pohon se ka vepruar sipas njoftimit të AKP mbi likuidimin e NSH dhe se ka dorëzuar kërkesë e tij kreditore sipas kategorive të cekura në Vendimet e AL.

Ankuesi kundërshtoj arsyetimin e Vendimeve të AL lidhur me parashkrimin duke konsideruar se i njëjti ka vepruar në pajtim me njoftimin e AL dhe se borxhet në paga ndaj punëtorëve gjithnjë janë pohuar nga ana e menaxhmentit të NSH. Andaj si rezultat i këtij pohimi, ankuesi konsideron se parashkrimi i aplikuar nga ana e AL është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve (neni 387 – pohim i borxhit).

Nga të gjitha arsyet e cekur si më lartë ankuesi i propozoj gjykatës që Vendimet e AL të rishqyrtohen.

Kërkesës për rishikim-ankesës i janë bashkangjitur:

- Kopjet e Vendimeve të AL,
- Kopjen e Autorizimit për përfaqësuesin, dhe
- Kopjen e Njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punëtorin ILMI STATOVCI, datë 4 mars 2005 (në tekstin në vijim NJOFTIMI).

AKP, me 16 shkurt 2016, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP fillimisht pohon se AL me rastin e vendosjes ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP kontestoj afatshmërinë e parashtrimit të kërkesës për rishikim-ankesës, pranë DHPGJS. AKP tutje pohoj se kërkesa për rishikim-ankesa nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore – LPK (neni 7- barra e provës). AKP përfundimisht pohoj se kërkesa është e pabazuar, dhe se të gjitha kërkesat mbi pagat respektivisht dëmshpërblim janë parashkruar në kuptim me nenin 608 të Ligjit për punën e bashkuar. Nga gjitha arsyet AKP propozoj që kërkesa për rishikim të refuzohet si e pabazuar dhe Vendimet e AL të vërtetohen.

Përfaqësuesi i ankuesit me 27 prill 2016 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesja mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim ashtu që kundërshtoj përgjigjen e AKP, mbeti pranë pohimeve rreth kundërshtimit, duke ju referuar shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit të punës dhe Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe qëndroj pranë asaj se ka vepruar sipas NJOFTIMIT.

AKP me 5 maj 2016 parashtroj kundërpërgjigje.

AKM mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

Duke vepruar sipas urdhrat të gjykatës, përfaqësuesi i ankuesit me parashtresën e tij të parashtruar pranë DHPGJS me 2 korrik 2024, parashtroj:

- Kopjen e Librezës së Punës e mbyllur me 28 shkurt 1991, dhe
- Kopjen e NJOFTIMIT.

Gjykata, gjatë shqyrtimit të lëndës, gjeti listën përfundimtare të Listës përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të hyrave (20%) nga privatizimi i NSH. Sipas kësaj liste të publikuar, përfundimtare, ankuesi nuk është i përfshirë në këtë listë (në tekstin në vijim LISTA E PUNËTORËVE).

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi me anë të kërkesës së tij për rishikim-ankesës, ka kërkuar kompensimin e pagave, dhe atë:

- a. tre (3) pagave të papaguara,
- b. dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, dhe
- c. pagave të papaguara duke filluar nga muaji shkurt i vitit 1991 gjer në privatizimin e NSH.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtresat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Gjykata konsideron se lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 dhe 1.6.2 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person si dhe e drejta në kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartëcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;
- b. Kontrata mbi punën i është ndërprerë para afatit të përfundimit, të saj;
- c. Pushimi nga puna ka ardhur si pasojë i Vendimit të AL, dhe
- d. Ndonjë veprim nga Agjencia, lidhur me administrimin e ndërmarrjes, shitjes, likuidimit etj.

Tutje sipas nenit 40 mbi prioritetin e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.7 parashihet përmbushja e kërkesave: *“kërkesat e pasiguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*.

Në interpretim të dispozitave të cekura si më lartë, në njërën anë, pohimeve të ankuesit dhe dëshmimeve të parashtruar nga ana e ankuesit, gjykata gjeti se asnjëra nga kushtet ligjore për të kërkuar të drejtën në paga nuk janë plotësuar respektivisht nuk janë dëshmuar.

Kopja e NJOFTIMIT, siç është përs shkruar si më lartë është lëshuar në emër të I S e jo në emër të ankuesit, tutje sipas kopjes së librezës së punës e prezantuar nga ankuesi shihet se i njëjti ishte i punësuar pranë NSH gjer me 28 shkurt 1991 e jo edhe gjer me datën e privatizimit të NSH dhe përfundimisht sipas LISTËS SË PUNËTORËVE e publikuar nga AKP, shihet se ankuesi nuk ishte punëtor i regjistruar i NSH në momentin e privatizimit të saj, ashtu siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/13 me plotësime dhe ndryshime.

Andaj nga të gjitha arsyet e cekura konsideron se ankuesi nuk e gëzon të drejtën e tij mbi kompensimin e pagave respektivisht dëmshpërblimit mbi ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1; 1.6.2; 1.7 si dhe ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Obiter dictum (ndër të tjerash)

Edhe pse kjo nuk është pjesë e këtij Aktgjykimi, gjykata konsideroj se AKP nuk ka dëshmuar afatshmërinë e kërkesës për rishikim të ankuesit. AKP në përgjigjen e saj, mbi afatin e dorëzimit të kërkesës për rishikim pranë DHPGJS i referohet datave të lëshimit të Vendimeve të AL, 13 janar 2013 gjersa kërkesa për rishikim e parashtruar me 6 janar 2014.

Gjykata konsideron se afati mbi parashtrimin e kërkesave rrjedh nga data e pranimit të Vendimeve të atakuara e jo nga data e lëshimit. Andaj konsideron se një pretendim i tillë i AKP konsiderohet i pabazuar.

Taksa Gjyqësore:

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar